

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për krime të rënda, divizioni penal, si gjykatë penale e shkallës parë**, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të pandehurit B.SH. nga fshati T., Komuna e V., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-s ), të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron av. Xh. Xh. nga Gj., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda PP.I.nr. 83/2016 të datës 10 maj të vitit 2016, të cilën e përfaqësoi prokurori i shtetit Arben Kadriu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, verbal dhe publik më datën 25 korrik të vitit 2016, mori dhe në prani të prokurorit të shtetit, të të pandehurit me mbrojtësin e tij në të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë,

### A K T G J Y K I M

**I. I pandehuri B.SH.** nga babai S. dhe nëna R – me mbiemër të vajzërisë R., i lindur më ... në fshatin T., Komuna e V., ku edhe jeton, posedues i telefonit mobil me SIM kartele..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i katër fëmijëve të mitur, ka të kryer shkollën fillore, i papunësuar, me gjendje të dobët ekonomike, i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale ndaj tij, i tërhiqet vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimin të tij nën kërcënim të pasojave ligjore me lëshuarje të urdhër arrestit e nëse plotësohen kushtet ligjore edhe të letër rreshtimit,

### Ë s h t ë f a j t o r

**Sepse** më datën ... pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armët e zjarra edhe atë : ... pushkë gjuetie vertikale ..., prodhim turk me nr. serik ..., ... armë automatike ... prodhim jugosllav, me nr. serik ..., katër karikatorë ... dhe ... fishekë të kalibrit ... mm, e të cilat armë gjatë bastisjes së shtëpisë së tij në fshatin T. Komuna e V. nga zyrtarët e Plicisë së kosovës i janë gjetur dhe sekuestruar,

- me çka ka kryer veprë penale **mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve** nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-s

Gjykata në bazë të dispozitave të cituara, nenit 4, 7, 21, 41, 45, 49-54, 73, 74 dhe 75 të KPRK-s si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale ( KPP-s ) të pandehurit në fjalë,

### I SHQIPTON DËNIM ME KUSHT

**Dënim me burgim** në kohëtgjatje prej **njëqindetëdhjetë ( 180 ) ditëve**, duke urdhëruar menjëherë që ky dënim mos të ekzekutohet nëse i pandehuri **në afatin verifikues prej një viti e gjashtë ( 6 )**, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale, nën kërcënim të revokimit të tij nëse plotësohen kushtet ligjore nga neni 53 dhe 54 të KPRK-s.

**II. Të pandehurit në fjalë** në kuptim të nenit 69 të KPRK-s lidhur me nenin 374 paragrafi 3 të KPRK-s i shqiptohet **DËNIMI PLOTËSUES** duke ju konfiskuar ... **pushkë gjuetie vertikale ... prodhim turk me nr. serik ..., ... armë automaktike e prodhimit jugosllav me nr. serik , ... karikatorë ... dhe ... fishekë të kalibrit ... mm**, sipas aktit të konfiskimit të datës ... nga oficeri policor E. A. me nr. të DI ... i Stacionit Policor në Viti – me numër të rastit policor ..., të cilat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi duhet të shkatërrohen përmes komisionit kompetent me proceverbal përkatës i cili duhet t'i bashkëngjitet kësaj lënde penale, poqese konform dispozitave ligjore të LESP nuk vendoset ndryshe nga personi i autorizuar gjatë ekzekutimit të këtij dënimi plotësues.

**III.** Në kuptim të nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.2 të KPRK-s, nëse i pandehuri një vit pas ditës së skadimit të periudhës së verifikimit të dënimit me kusht nuk kryen veprën tjetër penale, ose se nuk ka kryer veprën penale para veprës lëndore penale për të cilën është shpallur fajtor, të pandehurit do t'i shlyhet dënimi me kusht nga evidenca e personave të denuar duke arritur rehabilitimin ligjor, pa qenë e nevojshme që të bihet aktvendim i veçantë nga organi kompetent.

**IV. DETYROHET** i pandehuri në fjalë që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkritazi me paushallin gjyqësor në shumën prej **dyzetë ( 40 ) Euro**, në afat prej tridhjetë ( 30 ) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjiilan – DKR kundër të pandehurit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-s.

Kryetari i trupit gjykues menjëherë pas pranimit të lëndëve penale nga gjyqtari i pensionuar ka kontrolluar lëndët dhe me urdhresë ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar duke i ftuar palët përkatëse.

Pasi që i pandehuri gjatë seances së shqyrtimit fillestar është udhëzuar për të drejtat e tij ligjore, pas konsultimit me mbrojtësinë e tij me vetëdije të plotë dhe vulltet të lire ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale lëndore, të cilin nuk e kanë kundërshtuar as prokurori i shtetit e as mbrojtësi i të pandehurit, andaj kryetari i trupit gjykues pasi që vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 248 paragrafi 1 të KPRK-s me aktvendim procedural ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke e vazhduar seancën me deklaratat e palëve si në vijim.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pranimi i fajësisë ka mbështetje të plotë edhe në përvetësime tjera sin ë shkresa të lëndës dhe konstaton se ka kushte për pranimin e fajësisë andaj edhe gjykatës i ka propozuar që të pandehurin ta shpall fajtor dhe dënoj sipas Kodit penal duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, por edhe duke ia shqiptuar edhe dënimin plotësues lidhur me konfiskimin e armëve dhe municionit përkatës sin ë aktin akuzues.

Mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se, në tërësi pajtohet me deklaratën e të mbrojturit të tij lidhur me pranimin e fajësisë për veprën penale e cila i ngarkohet me aktakuzën lëndore, se i mbrojturi i tij është i vetëdijshëm për beneficionet që ia siguron pranimi i fajësisë, se i njëjti është penduar dhe premtom se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla e as të ngjashme penale. Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit trupit gjykues i propozon që t'i ketë parasysh rrethanat lehtësuese edhe atë pranimin e fajësisë, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, pendimin e sinqert, se është mbajtës i familjes, se është i pagjykuar dhe nuk zhvillohet procedure tjetër penale kundër tij, rrethana këto të mjasftueshme për shqiptimin e një dënimi të arsyeshëm.

I pandehuri ka deklaruar se e mbështet në tërësi deklaratën e mbrojtësit të tij duke u zotuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla e as të ngjashme.

Kryetari i trupit gjykues me qëllim që mos ta mbështesë aktgjykimin vetëm në pranimin e fajësisë së të pandehurit lidhur me dy veprat penale , në kuptim të nenit 361 të KPP ka vlerësuar edhe provat tjera në shkresa të lëndës të cilave pasi që jua ka falur besimin e plotë ka vërtetuar gjendjen faktike lidhur me këtë çështje penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të gjitha elementet objektive lidhur me veprën penale lëndore nuk janë kontestuese, duke i pasur parasysh provat e vlerësuar në shkresa të lëndës, të cilave gjykata jua ka falur besimin e plotë, e të njëjtat nuk i ka kundërshtuar as i pandehuri meqë ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndore.

Nuk është kontestues as elementi subjektiv i cili konsiston në dashje, pasi që e ka ditur se mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim të armëve dhe municionit të lartcekur është i ndaluar edhe pse për armën e gjuetisë më pare ka pasur leje por që atë nuk e ka vazhduar më tuitje.

Sa i përket përgjegjësisë penale gjykata ka vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e veprimit të tij kriminal dhe se ka mundur që veprimet e tilla kriminale t'i kontrolloj duke u përmbajtur nga veprimet e tilla të ndaluara me ligj, andaj edhe gjykata ka ardhur në përfundim se i pandehuri është penalisht i përgjegjshëm për veprën penale lëndore.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar më lart, por edhe elementet objektive dhe subjektive lidhur me çështjet penale lëndore, gjykata ka vërtetuar se i pandehuri është kryes dhe penalisht përgjegjës për veprat penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-s, për të cilën e ka shpallur fajtor, duke i shqiptuar dënimin e lartcekur të kushtëzuar me bindje se do të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 50 lidhur me nenin 41 të KPRK-s.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73-75 të KPRK-s edhe atë pranimin e fajësisë pa hezitim, pendimin e sinqert por edhe premtimin serioz se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale, se është mbajtës i vetëm i familjes, me gjendje të varfër ekonomike, se i njëjtë është i papunësuar, i pagjykuar por edhe se nuk zhvillohet procedure tjetër penale kundër tij, kurse rrethna rënduese nuk ka gjetur, mirëpo rrethant lehtësuese të konstatuara i ka trajtuar në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të KPRK-s si rrethana veçanërisht lehtësuese andaj edhe është përcaktuar për dënimin me burgim të kushtëzuar, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i plotë i dënimit.

Andaj, gjykata duke pasur parasysh gjendjen faktike të vërtetuar si dhe rrethanat e lartcekura është e bindur se edhe me një dënim me kusht mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 50 lidhur me nenin 41 të KPRK-s, duke e parandaluar të pandehurin që në të ardhmen mos të kryej vepra penale, por edhe duke e resocializuar të njëjtin përmes ngritjes së moralit dhe forcimit të detyrimit për respektimin e ligjit të vendit, por edhe për disiplinimin e qytetarëve potencial që mos të kryejnë vepra penale të kësaj natyre por edhe të ngjashme.

Lidhur me dënimin plotësues gjykata ka vendos në kuptim të nenit 69 lidhur me nenin 374 paragrafi 3 të KPRK-s, pasi që detyrimisht duhet konfiskuar objektin e veprës penale lëndore, për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor dhe dënuar me dënim me burgim me kusht sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i krimeve të rënda  
Divizioni Penal PKR.nr. 104/2016, më dt. 25 korrik të vitit 2016**

**Sekretarja juridike,  
Kadrije Zymberi**

**Kryetari i trupit gjykues,  
A.SH**

**Udhëzim për mjetin juridik:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i krimeve të rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë ( 15 ) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.